



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 647 Akti

Nr. 454 Vendimi
Tiranë, më 28.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Suela Zhegu	Relatore
Genta Tafa (bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 28.9.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Maksim Qirjazi**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 842016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Suela Zhegu, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Maksim Qirjazi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Me vendimin nr. 1, datë 15.12.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesues komisionerin Roland Ilia.

3. Në datën 27.1.2021, subjektit të rivlerësimit iu dërguar përbërja e trupit gjykues, si dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit. Në datën 28.1.2021, iu dërgua pyetëtori standard. Subjekti në datën 12.2.2021 ka depozituar përgjigjet e pyetësorit standard.

5. Komisioni me datë 10.9.2021 mori dijeni nga burime mediatike se subjekti i rivlerësimit, z. Maksim Qirjazi, ka ndërruar jetë. Në këto kushte, Komisioni iu drejtua me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2021, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të na vënë në dispozicion certifikatën e vdekjes për të ndjerin Maksim Qirjazi.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka informuar se z. Maksim Qirjazi ka ndërruar jetë në datën 9.9.2021, duke bashkëlidhur edhe certifikatën e vdekjes.

ARSYETIMI I KOMISIONIT

7. Subjekti i rivlerësimit, z. Maksim Qirjazi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligjit, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:

- a. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41.

9. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit, në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim:

- të nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sipas kësaj dispozite: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi.*”;
- të nenit 93/1 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet se: “*Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen*”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në nenet 90 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit, pa një vendim përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, Maksim Qirjazi.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.9.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland ILIA

Kryesues

Genta TAFA (BUNGO)

Suela ZHEGU

Anëtare

Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha